

VENDIM
Nr. 278, datë 21.5.2025

**PËR MIRATIMIN E NORMAVE DHE AFATEVE TË PËRDORIMIT TË
UNIFORMËS USHTARAKE QË PËRDORET NË SHËRBIMIN USHTARAK
REZERVIST TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 125/2024, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e normave dhe afateve të përdorimit të uniformës ushtarake që përdoret në shërbimin ushtarak rezervist të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas shtojcave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
- Ushtarakët e shërbimit rezervist të Forcave të Armatosura, të cilët dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, përfitojnë të njëjtin trajtim me uniformë si ushtarakët aktivë që marrin pjesë në këtë lloj veprimtarie.
- Uniforma, gradat, shenjat dhe simbolet, që mbahen në uniformë, jepen pa pagesë për ushtarakët e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.
- Kur ushtaraku i shërbimit rezervist humbet jetën në krye të detyrës, për ceremoninë e varrimit familjes së tij i jepet pa pagesë një uniformë ceremoniale (xhaketë, pantallona, kapele, këmbishë me mëngë të gjata, kollare dhe këpucë gjysmeceremoniale).
- Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
- Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Shtojca nr. 1

**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT E
SHËRBIMIT REZERVIST QË SHËRBEJNË NË STRUKTURAT E FORCAVE TË
ARMATOSURA**

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati në vite	
I.	UNIFORMA E STËRVITJES			
1.	Uniforma e stërvitjes kamuflazh			
1.	Kostum stërvitje (xhaketë, pantallona, kapelë)	2	4	Ngjyra e beretës do të jetë sipas strukturës ku shërben rezervisti
2.	Beretë	1	4	
3.	Xhup dimëror	1	6	
4.	Bluzë “polo” me mëngë të shkurtra	1	2	
5.	Bluzë me mëngë të gjata	2	4	
6.	Bluzë me mëngë të shkurtra	2	2	
7.	Pantallona të brendshme (benevrekë)	1	6	
8.	Rrip pantallonash	1	6	
9.	Rrip mesi	1	6	
10.	Çorapë të gjata	2	1	
11.	Këpucë stërvitjeje lëkure	1	4	
12.	Këpucë stërvitjeje lëkure/nailoni (verore)			Opsion në vend të këpucëve të

				stërvitjes të lëkurës
II.	UNIFORMA SPORTIVE			
1.	Kostum sportiv (pantallona + bluzë me mëngë të gjata)	1	4	
2.	Kostum sportiv (pantallona të shkurtra + bluzë me mëngë të shkurtra)	1	4	
3.	Këpucë sportive (atlete)	1	2	

Shënim

1. Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë, janë pjesë e uniformës.
2. Ngjyra e uniformës do të jetë ajo e strukturës ku shërben rezervisti.
3. Ushtarët e shërbimit rezervist që transferohen nga një strukturë në tjetrën, me përjashtim të atyre të Policisë Ushtarake, nuk e ndërrojnë uniformën, por mbajnë atë të origjinës.

Shtojca nr. 2

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE PËR USHTARAKËT E SHËRBIMIT REZERVIST TË FORCËS DETARE

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati në vite	
I.	UNIFORMA E STËRVITJES			
1.	Uniforma e lundrimit vetëm për detarin në anije.			
1.	Këmishë me mëngë të gjata blu	2	4	Opsion në vend të kostumit të stërvitjes “aquaflash”
2.	Pantallona taktike me xhepa anash	2	4	
3.	Xhup dimëror	1	6	
4.	Kapelë model “baseball” blu	1	4	
5.	Bluzë me mëngë të shkurtra blu	2	4	
6.	Bluzë me mëngë të gjata blu	2	4	
7.	Xhup dimëror me veshje të brendshme	1	6	
8.	Rrip pantallonash	1	6	
9.	Çorapë të gjata	2	1	
10.	Këpucë lundrimi	1	4	
11.	Pantallona lundrimi	1	6	
2.	Uniforma e detarit			
1.	Xhaketon leshi i zi	1	8	
2.	Këpucë me qafë, gjysmë	1	5	
3.	Kostum i bardhë (xhaketë, pantallona, sulinë, kapele me fjongo)	1	6	
4.	Bluzë me mëngë të shkurtra me vija	2	2	
5.	Bluzë me mëngë të gjata me vija	2	4	
6.	Pantallona të brendshme (benevrekë)	1	6	
7.	Rrip pantallonash	1	6	
8.	Çorapë të gjata	2	1	
9.	Kostum blu (xhaketë, pantallona, sulinë, kapele me fjongo)	1	6	
10.	Bluzë me mëngë të shkurtra me vija	2	2	
11.	Bluzë me mëngë të gjata me vija	2	4	
II.	UNIFORMA SPORTIVE			
1.	Kostum sportiv (pantallona +	1	4	

	bluzë me mëngë të gjata)			
2.	Kostum sportiv (pantallona të shkurtra + bluzë me mëngë të shkurtra)	1	4	
3.	Këpucë sportive (atlete)	1	2	

Shënim 1. Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë, janë pjesë e uniformës.

2. Detarët që transferohen në një strukturë tjetër e ndërrojnë uniformën e origjinës.